URDHËR
Nr. 74, datë 9.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të nenit 11 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.2.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për nënshkrimin e dokumentacionit të klasifikuar, nga data 9.3.2026 deri në plotësimin e detyrimeve ligjore për njohjen me informacionin e klasifikuar, tek anëtari i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Altin Hoxha.
2. Ngarkohet anëtari i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Altin Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Gentiana Sula